



**VENDIM**

*Nr. 114 Datë 07.10.2013*

**PËR**

**MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË “SELCA ENERGJI”  
SH.P.K ME NR. 102, SERIA PV10P PËR “PRODHIMIN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE” NGA HEC “SELÇË”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 39, DATË 05.05.2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 13; 14 pika 2; 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4; të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr. 102, Seria PV10P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 39, datë 05.05.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”**: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”**: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të modifikojë liçensën me nr.102, Seria PV10P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec "Selcë" me fuqi 400 KW, të miratuar me Vendimin e Bordi i Komisionerëve Nr. 39, datë 05.05.2010.
2. Fuqia e instaluar e Hec "Selcë", nga 400 KW të bëhet 1600 KW.
3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë  
Shkëlqim Bozgo**